



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

K.DH.SH.II.nr.1026/22

GJYKATA KOMERCIALE – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitija-Ymeri dhe Krenar Berisha, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NTSH “D...” me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Sh.A. “S...P...” ShPK, ...P+12 Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK), në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.942/20, të datës 05.07.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.02.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e paditësit NTSH “D...” me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizion Fiskal, A.nr.942/20, të datës 05.07.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizion Fiskal, A.nr.942/20, të datës 05.07.2021, nën pikën I të dispozitivit është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit NTSH “D...” me seli në Prishtinë. Në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, është lënë në fuqi aktvendimi nr.01.3.2.2/3826 i datës 20.03.2020, i Doganës së Kosovës në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë paditësi, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave procedurale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të dispozitave materiale dhe rritjes së paarsyeshme të çmimit të mallit. Me propozim që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e paditësit dhe të anulohet aktgjykimi A.nr. 942/20 i datës 05.07.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtuan shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.h të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe

Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kundërshtuar nr.01.3.2.2/3826 i datës 20.03.2020, i Doganës së Kosovës në Prishtinë, është refuzuar kërkesa e subjektit në procedurë NTSH "D..." me seli në Prishtinë, për rishqyrtimin e vendimit R-6429/10.02.2020 të ZBD Prishtinë, si e pa bazuar.

Paditësi i pa kënaqur me aktvendimin e lartcekur të Doganës së Kosovës në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i paligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër aktvendimit nr.01.3.2.2/3826 i datës 20.03.2020, i Doganës së Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar, duke lënë në fuqi aktvendimin e lartcekur të Doganës së Kosovës në Prishtinë. Me arsyetim se nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, paditësi ka deklaruar mallin për zhdoganim në Zyrën e Brendshme Doganore Prizren, me ç'rast pas pranimit dhe vlerësimit të DUD-it kontestues, mallin lëndor e ka rivlerësuar në bazë të metodës së gjashtë(6) të vlerësimit në pajtim me nenin 35 të KDA-së respektivisht në bazë të dhënave të disponueshme duke konstatuar se dokumentacioni përcjellës i mallit lëndor është i pamjaftueshëm pasi që paditësi nuk ka prezantuar dokumentacion të kompletuar për të përcaktuar vlerën reale për mallin lëndor dhe paditësi është detyruar që të paguaj taksën doganore më të lartë se të deklaruar me faturën përcjellëse. Prandaj, gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se në rastin konkret transaksioni bankar i datës 06.01.2020 në vlerë prej 33,478.88\$ nuk përputhet me vlerën e faturës dhe vlerën e deklaruar në shumën prej 31,978.87\$. Nga ky rezultat e paditura me të drejtë ka rivlerësuar mallin lëndor për shkak se paditësi nuk ka dëshmuar me prova konkrete pretendimet e tij para gjykatës në këtë konflikt administrativ, ndërsa provat tjera nuk janë të mjaftueshme dhe bindëse për të pranuar vlerën e mallit lëndor.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranojnë edhe Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 81G të Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe

Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, ky pretendim nuk qëndron meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për faktin se e paditura ka zbatuar në mënyrë të gabuar dispozitat e Kodit Doganor me rastin e nxjerrjes së aktvendimit të lartcekur. Këto pretendime ankimore janë të pa bazuara, ngase kolegji i kësaj gjykate konsideron se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara, kjo për faktin se nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka gjetur se paditësi nuk ka prezantuar fakte-dokumente të bazuara që argumentojnë se ka paguar vlerën reale sipas faturave përcjellëse të mallit lëndor, të cilat fakte-dokumente është obligim i paditësit-deklaruesit të mallit lëndor t'ia bashka ngjisë DUD-it kontestues, një ashtu paditësi-subjekti në procedurë nuk ka dëshmuar mënyrën e pagesës me prova konkrete para gjykatës në këtë konflikt administrativ ndërsa provat tjera nuk janë të mjaftueshme dhe bindëse për të pranuar vlerën e mallit lëndor. E paditura ka aplikuar me të drejtë dispozitën ligjore të KDA-së përkatësisht nenin 35 i cili parasheh zbatimin e metodës së gjashtë të vlerësimit: *“Kur vlera doganore e mallrave të importuara nuk mund të përcaktohet në bazë të nenit 33 ose 34 do të përcaktohet në bazën e të dhënave të disponueshme në Kosovë, duke përdorë metoda të arsyeshme në përputhje me parimet dhe dispozitat e përgjithshme”* dhe në këtë mënyrë ka ngritur bazën doganore për mallin që është objekt lëndor i këtij konflikti administrativ. Prandaj, nga kjo gjendje faktike, gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit kontestues të paditurës, sepse paditësi në procedurë ankimore tek e paditura, por edhe para gjykatës nuk ka paraqitur prova me të cilat dëshmon pretendimet e tij, ndërsa faktet e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosjen ndryshe të kësaj çështje administrative-juridike. Pra, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, kjo gjykatë gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur është bazuar në dispozitat e LKA, Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222, dhe nenin 46 par.2 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Lidhur me pretendimet e paditësit se me rastin e paraqitjes së mallit për zhdoganim përmes deklaratës doganore R-6429/10.02.2020 ka paraqitur dokumentet që dëshmojnë për çmimin e

vërtetë për mallin e paguar, këto pretendime ankimore janë të pa bazuara për faktin se siç shihet edhe në shkresat e lëndës vlera në faturën e datës 19.12.2019 me nr.HD1901219-01 nuk harmonizohet me urdhër pagesën e datës 06.01.2020. Andaj kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoj dhe i vlerësoj pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje, pasi që vlera e transaksioneve bankare nuk është e harmonizuar me faturën dhe vlerësoj se e paditura në rastin konkret ka aplikuar metodën e gjashtë të vlerësimit përkatësisht nenin 35 të Kodit Doganor dhe i Akcizave të Kosovës respektivisht në bazë të dhënave të disponueshme, duke u bazuar edhe në zhdoganimet e mëhershme të mallrave të ngjashme që kanë karakteristika të ngjashme me mallin kontestues por që kanë vlerë më të lartë të transaksionit, pasi në procedurën administrative tek e paditura nuk janë paraqitur prova për të dëshmuar saktë se vlera e mallit e paraqitur për zhdoganim është vlerë reale e paguar për mallin lëndor kontestues.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVES

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1026/22, me datë 22.02.2023

Kryetari i kolegjit, gjyqtari

Dren Rogova